



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Shkodër, më . . .2026

**PROCESVERBAL**  
**TIPI I KONTRATËS – MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE**  
**KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE DRU ZJARRI DHE PELET”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 03413000-8 – Dru zjarri.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 74,999,998 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH dhe 785,547.06 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë pikë zero gjashtë) Euro pa TVSH.**

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të [Bankës së Shqipërisë](#) për datën 26.05.2026, ku 1 Euro = 95.47 lekë.

**ARGUMENTIMI:**

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS**

Në vijim të Urdhrit nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri dhe pelet”, grupi i punës, pasi u njoh me objektin e prokurimit, filloi punën për hartimin e dokumentacionit përkatës.

Grupi i punës u mbështet në:

1. Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.84, datë 19.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”;

2. Preventivin dhe specifikimet teknike të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike;
3. Nevojat reale të Autoritetit Kontraktor për furnizimin e institucioneve në varësi.

## **PËRLLOGARITJA E FONDIT LIMIT**

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor iu referua nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni organizoi punën për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese të tregut për mallrat objekt prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve rezultoi se:

- Listat e publikuara nga INSTAT nuk përmbajnë të dhëna për mallrat objekt prokurimi;
- Institucione të tjera zyrtare nuk disponojnë publikime përkatëse.

Për këtë arsye grupi i punës u mbështet në:

- hetimin e tregut vendas;
- çmimet e kontratave të mëparshme të ngjashme;
- informacionin tregtar të operatorëve ekonomikë.

Pas analizës së të dhënave teknike dhe ekonomike, vlera e përgjithshme e fondit limit rezultoi: 74,999,998 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH dhe 785,547.06 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë pikë zero gjashtë) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të [Bankës së Shqipërisë](#) për datën 26.05.2026, ku 1 Euro = 95.47 lekë.

## **AFATET E LËVRIMIT**

Furnizimi i druve të zjarrit dhe peletit do të realizohet nga ora 08:00 deri në orën 16:00, nga e hëna në të premte, në institucionet në Qytet dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër, sipas grafikut të shpërndarjes që do t’i vihet në dispozicion operatorit ekonomik fitues. Furnizimi fillon më 1 Nëntor.

## **ARGUMENTIM MBI PËRZGJEDHJEN E PROCEDURËS ME MARRËVESHJE KUADËR**

Kjo procedurë prokurimi është parashikuar të zhvillohet në formën e marrëveshjes kuadër, bazuar në nenin 35 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenet 54-61 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Përdorimi i marrëveshjes kuadër argumentohet me faktin se furnizimi me dru zjarri dhe pelet do të realizohet sipas nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor gjatë periudhës së zbatimit të kontratës dhe në përputhje me grafikun e shpërndarjes për institucionet në administrim të Bashkisë Shkodër.

Për shkak të natyrës së mallrave objekt prokurimi, të cilat kërkohen në mënyrë periodike dhe të shpërndarë gjatë sezonit të furnizimit, Autoriteti Kontraktor nuk mund të përcaktojë me saktësi momentin dhe sasinë përfundimtare të furnizimit për secilin institucion përfitues.

Përdorimi i marrëveshjes kuadër garanton:

- fleksibilitet në realizimin e furnizimeve sipas nevojave reale;
- përdorim efikas të fondeve publike;
- vazhdimësi të furnizimit;
- realizim në kohë të nevojave të Autoritetit Kontraktor.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbeshtetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:** Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 9).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenin 40 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e kërkuara të mos jetë më e vogël se fondi limit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura pranë Administratës Tatimore dhe të konfirmuara prej saj, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastet kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi për auditimin ligjor dhe pasqyrat financiare.

Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Kjo kërkesë mbështetet gjithashtu në: Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, aq sa vijon të jetë i zbatueshëm; Legjislacionin fiskal në fuqi për deklarimin dhe administrimin e pasqyrave financiare.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë me qëllim verifikimin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe kapaciteteve financiare të operatorëve ekonomikë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokument që vërteton se ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, të lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin ekonomik, sipas ekstraktit të QKB-së dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik kanë detyrimin e pagesës së taksave dhe tarifave vendore pranë njërive të vetëqeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin.

Paraqitja e këtij dokumentacioni kërkohet me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe garantimin e besueshmërisë së tyre financiare dhe administrative në realizimin e kontratës.

**2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **Argumentimi:**

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është përcaktuar në përpjesëtim me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës dhe është brenda kufirit maksimal të përcaktuar në nenin 40, pika 4, të VKM nr.285/2021.

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë realizuar më parë furnizime të ngjashme, në afat dhe me cilësinë e kërkuar, duke rritur besueshmërinë për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton origjinën dhe burimin e ligjshëm të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:

a) Për furnizimin me dru zjarri:

- Kontratë furnizimi me subjektin shitës (Bashki/Koncesionar), të shoqëruar me:
  - lejen përkatëse të shfrytëzimit të pyllit;
  - faturën tatimore të shitjes;

ose

- Kontratë furnizimi me operatorë ekonomikë të tretë, të cilët furnizohen nga Bashki/Koncesionar, të shoqëruar me:
  - kontratën e furnizimit ndërmjet tyre dhe Bashkisë/Koncesionarit;
  - lejen e shfrytëzimit të pyllit;
  - faturën tatimore të shitjes nga Bashkia/Koncesionari;
  - faturën tatimore të blerjes.

b) Për mallrat e importuara:

- Në rast se operatori ekonomik është importues, duhet të paraqesë deklaratën doganore të importit.
- Në rast se operatori ekonomik nuk është importues i drejtpërdrejtë, duhet të paraqesë kontratë furnizimi me importuesin, të shoqëruar me faturën tatimore të blerjes.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë origjinën, burimin e ligjshëm dhe gjurmueshmërinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe disponueshmërinë reale të tyre për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e mallrave objekt prokurimi, për të cilat legjislacioni përkatës parashikon detyrimin për pajisje me leje shfrytëzimi nga organet kompetente, si dhe dokumentacionin përkatës tatimor dhe doganor.

Paraqitja e dokumentacionit të mësipërm i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar ligjshmërinë e burimit të mallrave, kapacitetet furnizuese të operatorit ekonomik dhe garantimin e realizimit të kontratës në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike të procedurës së prokurimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e mëposhtme, të vlefshme dhe të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë:

- ISO 9001 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente;
- ISO 14001 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalente;
- ISO 45001 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalente.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga organe të pavarura të akredituara, për të vërtetuar përputhshmërinë e operatorit ekonomik me standarde të caktuara të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë, për aq sa këto kërkesa janë të lidhura dhe proporcionale me objektin e prokurimit.

Kërkesa për certifikatën ISO 9001 është vendosur me qëllim garantimin e standardeve të menaxhimit të cilësisë në realizimin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik

disponon procedura dhe kapacitete administrative e organizative për furnizimin e mallrave sipas kërkesave teknike dhe brenda afateve të përcaktuara.

Kërkesa për certifikatën ISO 14001 lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin produkte dhe procese që kanë ndikim në mjedis. Nëpërmjet këtij standardi kërkohet të garantohet se operatori ekonomik zbaton praktika të kontrollit dhe menaxhimit mjedisor gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

Kërkesa për certifikatën ISO 45001 është vendosur me qëllim garantimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë për personelin e angazhuar në realizimin e kontratës, duke minimizuar rreziqet gjatë proceseve të transportit, ngarkim-shkarkimit dhe përpunimit të mallrave objekt prokurimi.

Këto certifikata janë në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e kontratës dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të verifikuar aftësinë teknike, organizative dhe profesionale të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Leje Mjedisi Tipi B, të vlefshme, të lëshuar nga organet kompetente, për ushtrimin e veprimtarive të lidhura me objektin e prokurimit, konkretisht:

- Kategoria III.1.B – Veprimtari të lëndës drusore, ku të përfshihen sharrimi i drurit, përpunimi i lëndës drusore dhe prodhimi i produkteve të përbëra prej druri, përfshirë peletin, së bashku me aktmiratimin përkatës;
- Kategoria III.2.B – Grumbullim, transportim dhe përpunim i mbetjeve të lëndës drusore, së bashku me aktmiratimin përkatës.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 5, germa “a”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë licenca, autorizime apo leje specifike për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi.

Kjo kërkesë mbështetet gjithashtu në Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, që përcaktojnë kategoritë e veprimtarive të pajisura me leje mjedisore.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë se ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe disponojnë autorizimet përkatëse për prodhimin, përpunimin, transportin dhe furnizimin e mallrave objekt prokurimi.

Kërkesa është në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe objektin e kontratës dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të garantuar se operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet ligjore, teknike dhe mjedisore për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.5** Operatori ekonomik, në rast se është prodhues i mallrave objekt prokurimi, duhet të paraqesë licencë/leje për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të peletit, Tipi B, Kategoria III.1.B, të vlefshme, të lëshuar nga organet kompetente.

Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i Autorizuar, të vlefshëm, për tregtimin e produktit objekt prokurimi.

Në rast se autorizimi paraqitet nga Distributori i Autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe marrëveshjen/kontratën ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të Autorizuar, të vlefshme.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të prodhuesit/distributorit, si: adresën, telefonin, adresën elektronike (e-mail) dhe faqen zyrtare të internetit, me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë të drejtën ligjore për prodhimin, furnizimin ose tregtimin e mallrave objekt prokurimi dhe se kanë mbështetjen e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për realizimin e kontratës.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me garantimin e origjinës, cilësisë dhe disponueshmërisë së mallrave objekt prokurimi, si dhe me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të kontratës.

Paraqitja e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar lidhjen zyrtare të operatorit ekonomik me burimin e furnizimit dhe për të garantuar furnizimin me mallra sipas specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Kërkesa është në përputhje të drejtë me natyrën dhe rëndësinë e kontratës dhe nuk krijon kufizim të konkurrencës, pasi pranohet si autorizimi nga prodhuesi, ashtu edhe autorizimi nga distributori i autorizuar.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në mënyrë elektronike në sistem fletë-analizën/test-raportin e produktit objekt prokurimi, të lëshuar nga laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produktit me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Rezultatet e testimeve zyrtare duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Dokumentacioni që provon akreditimin e laboratorit do të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara lidhjes së kontratës, ose në rast se kërkohet nga Autoriteti Kontraktor për qëllime verifikimi.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, lidhur me paraqitjen e dëshmimeve dhe rezultateve të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuara, të cilat vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet të garantohet që produktet objekt prokurimi përmbushin parametrat teknikë, standardet e cilësisë dhe kërkesat funksionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e mallrave objekt prokurimi dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar cilësinë, sigurinë dhe përputhshmërinë teknike të produkteve që do të furnizohen.

Afati 3-mujor i vlefshmërisë së analizave është përcaktuar me qëllim garantimin e aktualitetit dhe vlefshmërisë së rezultateve laboratorike për produktet që do të ofertojnë në këtë procedurë prokurimi.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e nevojshme të transportit për realizimin e kontratës, si më poshtë:

- a. 2 (dy) automjete vetëshkarkuese me masë mbi 3.5 ton;
- b. 1 (një) automjet vetëshkarkues me masë deri në 1.5 ton.

Për mjetet e mësipërme duhet të paraqitet dokumentacioni si vijon:

- Për mjetet në pronësi, të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, policia e sigurimit të detyrueshëm dhe certifikata e transportit e vlefshme;
- Për mjetet e marra me qira ose në përdorim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale, e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit dhe certifikatën e transportit të vlefshme;
- Për të gjitha mjetet të paraqiten foto për identifikimin e tyre.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të Dokumenteve të Tenderit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin*

*provues për vetëdeklarimet e paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentimi:**

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5, germa “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kërkesa për disponimin e mjeteve të transportit është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe është në përpjesëtim me natyrën, vëllimin dhe mënyrën e realizimit të furnizimit. Duke qenë se furnizimi do të kryhet në mënyrë periodike dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, si dhe duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike të institucioneve përfituese, disponimi i mjeteve të mjaftueshme të transportit është i domosdoshëm për garantimin e realizimit në kohë dhe me cilësi të kontratës.

Përcaktimi i numrit dhe tipologjisë së mjeteve është bërë mbi bazën e nevojave konkrete për transportin dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit, përmbushjen e grafikut të shpërndarjes dhe shmangien e vonesave gjatë ekzekutimit të kontratës.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër realizimin e furnizimit me mjetet e veta të transportit, në të gjitha pikat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, sipas grafikut të shpërndarjes.

**Argumentimi:**

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përmes kësaj kërkesë, Autoriteti Kontraktor synon të sigurohet që operatori ekonomik ofertues merr përsipër realizimin e furnizimit në të gjitha institucionet përfituese, në përputhje me grafikun dhe shpërndarjen gjeografike të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Kjo deklaratë kërkohet për të garantuar kapacitetin organizativ dhe logjistik të operatorit ekonomik për realizimin në kohë dhe pa ndërprerje të furnizimeve, duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, shpërndarjen në disa pika furnizimi dhe nevojën për respektimin e afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Kërkesa është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe i shërben garantimit të zbatimit me sukses të kontratës.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për numrin mesatar të punonjësve për 3 (tre) muajt e fundit, i cili të jetë jo më i vogël se 8 (tetë) punonjës, lëshuar nga administrata tatimore, i shoqëruar me listëpagesat përkatëse.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të Dokumenteve të Tenderit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin.*

#### **Argumentimi:**

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5, germa “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë dëshmi mbi kapacitetet teknike dhe profesionale, përfshirë disponimin e fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kërkesa për disponimin e një numri minimal prej 8 (tetë) punonjësish është vendosur në funksion të garantimit të realizimit me sukses të kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën e furnizimit, volumin e punës, grafikun e shpërndarjes dhe shtrirjen gjeografike të institucioneve përfituese. Furnizimi parashikohet të kryhet në mënyrë periodike dhe brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, çka kërkon angazhimin e një personeli të mjaftueshëm për përgatitjen, ngarkim-shkarkimin, transportin dhe shpërndarjen e mallrave.

Përcaktimi i numrit minimal të punonjësve është bërë në përpjesëtim me objektin dhe përmasat e kontratës dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar se operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe organizative për realizimin e kontratës në kohë dhe me cilësi.

Gjithashtu, kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit tatimor dhe listëpagesave synon të verifikojë marrëdhëniet e rregullta të punësimit dhe formalizimin e fuqisë punëtore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar / të kualifikuar, si më poshtë:

- a. 2 (dy) drejtues mjetei për kategorinë e mjeteve të kërkuara;
- b. 2 (dy) punonjës me dëshmi kualifikimi për përpunues druri, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik ose ekuivalente me të.

Për stafin e sipërcituar duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton kualifikimin profesional, si dëshmi profesionale ose dokument ekuivalent.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të Dokumenteve të Tenderit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, në origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentimi:**

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5, germa “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë dëshmi mbi kapacitetet teknike dhe profesionale, përfshirë personelin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale për realizimin e kontratës.

Kërkesa për drejtues mjetesësh është vendosur në funksion të garantimit të transportit dhe shpërndarjes së mallrave objekt prokurimi, në përputhje me grafikun dhe shpërndarjen gjeografike të institucioneve përfituese. Ndërsa kërkesa për punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi për përpunimin e drurit lidhet drejtpërdrejt me natyrën e produktit objekt prokurimi dhe procesin e përgatitjes, trajtimit dhe furnizimit të tij.

Përcaktimi i numrit minimal të punonjësve të specializuar është bërë mbi bazën e volumeve të furnizimit, kërkesave teknike dhe nevojës për realizimin e kontratës në kohë, me cilësi dhe në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

Kjo kërkesë i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar se operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet profesionale, teknike dhe organizative të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, si dhe garanton që shërbimi/furnizimi do të realizohet nga personel i kualifikuar dhe i përshtatshëm për natyrën e objektit të prokurimit.

**2.3.11** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) në ditën e hapjes së ofertave, në vendin e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, jo më pak se një kampion në paketim origjinal për produktin objekt prokurimi.

Mostra e kërkuar duhet të ketë një etiketë të ngjitur, e cila të përmbajë: emrin e artikullit, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e Tenderit.

**Argumentimi:**

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë paraqitjen e mostrave, katalogëve apo dëshmive të testimive zyrtare për të verifikuar përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe është vendosur me qëllim verifikimin konkret të cilësisë, karakteristikave teknike dhe përputhshmërisë së produktit të ofertuar me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Duke qenë se mallrat objekt prokurimi janë produkte specifike, paraqitja e mostrave është e nevojshme për të vlerësuar përmbushjen e standardeve teknike dhe funksionale të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Nëpërmjet mostrave, Autoriteti Kontraktor do të verifikojë elementë të tillë si: cilësia e produktit, përputhshmëria me specifikimet teknike, origjinaliteti i produktit, përshkrimet teknike, paketimi, si dhe karakteristikat e tjera funksionale të mallrave objekt prokurimi.

Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të administrohen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ato mund t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, pas përfundimit të procedurës së prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës, me kusht që procedura të mos jetë objekt shqyrtimi administrativ apo gjyqësor, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

## **2.4 Kriteri për shpalljen e ofertës fituese**

Bazuar në nenin 45, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, për mallrat që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe që gjenden lehtësisht në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme përcaktohet mbi bazën e çmimit si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

Në këtë procedurë prokurimi, objekti i kontratës përbëhet nga mallra standarde, me karakteristika teknike të përcaktuara qartë dhe të krahasueshme, për të cilat tregu ofron një gamë të gjerë furnizuesish dhe produktesh të disponueshme. Për këtë arsye, vlerësimi i ofertave mbi bazën e çmimit më të ulët është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe garanton përdorimin me eficiencë të fondeve publike.

Përcaktimi i këtij kriteri synon të sigurojë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, transparencë dhe konkurrencë efektive, duke qenë se të gjitha kërkesat teknike dhe kriteret kualifikuese janë përcaktuar më parë në Dokumentet e Tenderit dhe çdo ofertues duhet të provojë përmbushjen e tyre. Në këto kushte, çmimi mbetet elementi i vetëm dallues ndërmjet ofertave të vlefshme dhe të kualifikuara.

Ky kriter është vendosur në përputhje me parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe përdorimit efektiv të fondeve publike, të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

## **II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike**

Në hartimin e specifikimeve teknike është respektuar parimi i mosdiskriminimit dhe i trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Për këtë arsye, specifikimet teknike nuk përmbajnë referenca ndaj ndonjë marke prodhimi, origjine specifike, patente, tipi, procesi të veçantë prodhimi apo marke tregtare, të cilat do të kishin efekt favorizimin apo kufizimin e konkurrencës. Në rastet kur referimi i tillë është i domosdoshëm për shkak të pamundësisë së përshkrimit të saktë dhe të kuptueshëm të objektit të prokurimit, ai është shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 36 të LPP-së.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për mallrat objekt prokurimi, duke përcaktuar sasisë, karakteristikat teknike dhe

standardet minimale të kërkuara, në funksion të garantimit të cilësisë, funksionalitetit dhe përdorimit të sigurt të produkteve që do të furnizohen. Hartimi i tyre është bërë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë.

Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit, preventivi, afatet e realizimit dhe kriteret e kualifikimit janë hartuar nga strukturat përgjegjëse dhe grupi i posaçëm i punës i ngritur për këtë procedurë, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteret teknike dhe kualifikuese janë përcaktuar në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe janë vlerësuar si të nevojshme, proporcionale dhe të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit, pa krijuar pengesa të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë.

Dokumentet e tenderit, së bashku me kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, preventivin dhe dokumentacionin tjetër shoqërues, janë miratuar dhe firmosur nga anëtarët e njësisë së prokurimit, të cilët, pas miratimit përfundimtar, autorizohen për publikimin e tyre në sistemin elektronik të prokurimit publik pranë Agjencia e Prokurimit Publik nëpërmjet platformës zyrtare elektronike.